

Stampa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë / a

2

2

3628

07/10/2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauke i
Tehnologije - Ministry of Education, Science and Technology

Datë: 07.10.2013
Nr. 213693
Prishtinë

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010 dhe nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 dhe UA 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë nxjerr këtë:

V e n d i m

Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – Kolegji “Dukagjini” në Pejë. Ky institucion i ka plotësuar kushtet e kërkuara sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe udhëzimeve përkatëse administrative për organizimin e procesit mësimor dhe kërkimor e shkencor në nivelin 5 dhe 6 sipas ISCED (Baçelor dhe Master),

1. Bartësi Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – Kolegji “Dukagjini” licencohet në nivelin Bachelor dhe Master.
2. Kohëzgjatja e licencës së Kolegjit “Dukagjini” është tri vite.
3. Kolegji “Dukagjini” punon me programet e akredituara nga AKA.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni për licencimin e Bartësve Privatë të Arsimit të Lartë i ka udhëhequr procedurat e nevojshme administrative dhe profesionale me qëllim të vlerësimit të këtij BPrAL dhe ka konstatuar se:

- a) Kolegji “Dukagjini” ka plotësuar këto kushte dhe kriteret të parapara në LAL dhe UA për licencim:

- b) ka infrastrukturë fizike dhe pajisje teknologjike që ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor-shkencor,
- c) ka kuadër të kualifikuar për mësimdhënie në arsimin e lartë,
- d) ka dokumentacionin e kompletuar, sipas kushteve të vëna në udhëzimin përkatës administrativ të MASHT,
- e) ka plane mësimore dhe programe të studimit që i plotësojnë kërkesat themelore për punë cilësore të këtij niveli,

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në komisionin për ankesa në MASHT-të, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet :

- Arkivit të MASHT-it,
- Parashtruesit të kërkesës,
- Komisionit për licencimin,
- Zyrës së arsimit privat.
- Departamentit të Inspektimit

